



UNMIK/REG/2002/12  
13 qershor 2002

---

## **RREGULLORE NR. 2002/12**

### **MBI THEMELIMIN E AGJENCISË SË MIRËBESIMIT TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në bazë të kompetencave që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Pas konsultimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal dhe me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës,

Me qëllim të themelimit të Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

#### **Kapitulli 1** **Statusi ligjor, qëllimi dhe përkufizimet**

##### **Neni 1** **Statusi ligjor i Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës**

Agjencia e Mirëbesimit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “Agjencia”) është themeluar si një organ i pavarur në pajtim me nenin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Agjencia ka identitet të plotë juridik, e në veçanti aftësi për të bërë kontrata, për të marrë, ruajtur dhe për të shitur pasurinë, si dhe kompetencat e vetkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë Rregullore, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

## Neni 2 Objektivi dhe qëllimet

2.1 Në pajtim me kushtet e parapara në këtë Rregullore, Agjencia administron me ndërmarrjet në pronësi publike dhe shoqërore dhe me pasurinë e tyre, në kuptimin e nenit 8.1(II) të kornizës Kushtetuese. Sa i përket ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, Agjencia do të ketë kompetenca shtesë të parapara në nenin 6.2 të kësaj Rregulloreje.

2.2 Për ta realizuar këtë objektiv, Agjencia do të:

(a) Administrojë ndërmarrjet si administrues i besuar i pronarëve të tyre, në pajtim me këtë Rregullore dhe rregulloret e tjera, si dhe urdhëresat administrative dhe vendimet që mund t'i nxjerrë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm;

(b) Zhvillojë aktivitete ndihmëse për të ruajtur ose avancuar vlerën, shanset për sukses dhe qeverisjen e ndërmarrjeve dhe

(c) Kryejë detyra të tjera të caktuara sipas Rregullores.

## Neni 3 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

“Agjenci” do të thotë Agjencia e Mirëbesimit e Kosovës.

“Ligji në fuqi” do të thotë ligji në fuqi në Kosovë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 1999/24 të datës 2 dhjetor 1999 (si dhe ndryshimet) mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë.

“Bord” do të thotë Bordi i drejtorëve të Agjencisë.

“Kornizë Kushtetuese” do të thotë Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001).

“Korporatë” do të thotë ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare e regjistruar në Kosovë dhe e pranuar si e tillë sipas Rregullores për Organizatat e Biznesit.

“Kreditor” do të thotë personi ose subjekti që pohon se është kreditor i një ndërmarrjeje, ose pretendim për ndonjë të drejtë pronësie apo hipotekë tjetër lidhur me pasurinë e një ndërmarrjeje.

“Drejtor” do të thotë anëtari i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës.

“Ndërmarrje” do të thotë çdo ndërmarrje dhe pasuri që Agjencia e ka nën kompetencë për ta administruar në pajtim me nenin 5.

“Ligji mbi ndërmarrjet” do të thotë ligji i ndryshuar mbi ndërmarrjet i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

“Menaxhment” do të thotë drejtori i menaxhimit dhe zëvendësdrejtorët e menaxhimit të Agjencisë, kolektivisht dhe individualisht.

“Pronar” do të thotë personi ose subjekti që pohon të jetë pronar i një ndërmarrje.

“Ndërmarrje në pronësi publike” do të thotë një ndërmarrje që është themeluar si ndërmarrje në pronësi publike nga Krahina e Kosovës, nga një komunë ose organizatë tjetër publike-politike brenda Krahinës së Kosovës, Republikës së Serbisë ose Republikës Federative të Jugosllavisë apo ndonjë organizatë publike-politike e Republikës së Serbisë apo Republikës Federative të Jugosllavisë, me kusht që çdo ndryshim vijues për krijimin e ndërmarrjes së tillë duhet të administrohet sipas neneve 5.3 dhe 5.4.

“Rregullore mbi Organizatat e Biznesit” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2001/6, e datës 8 shkurt 2001 mbi Organizatat e Biznesit.

“Ndërmarrje në pronësi shoqërore” do të thotë një ndërmarrje që është themeluar si ndërmarrje në pronësi shoqërore sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet, Ligjit mbi Punën e Bashkuar të Republikës Federative të Jugosllavisë ose cilitdo ligji tjetër në fuqi, me kusht që çdo ndryshim i mëtejshëm për krijimin e ndërmarrjes së tillë të administrohet sipas neneve 5.3 dhe 5.4.

“Dhoma e Veçantë” do të thotë Dhoma e Veçantë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës e cila do të themelohet në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13, të datës 13 qershor 2002, mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës.

Fjalët e cilësdo gjini të përdorura në këtë Rregullore përfshijnë cilëndo gjininë tjetër dhe fjalët në njëjës nënkuptohet se përfshijnë edhe shumësin ndërsa shumësi njëjës.

#### Neni 4 Referimet

Referimet në kapituj, nene dhe paragrafe vlejné për këtë Rregullore, përveç nëse nëse shprehimisht është thënë ndryshe.

## **Kapitulli 2** **Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë**

### Neni 5 Ndërmarrjet nën administrimin e Agjencisë

5.1 Agjencia do të ketë kompetenca që t'i administrojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe publike të regjistruara ose veprojnë në territorin e Kosovës si dhe pasurinë e këtyre ndërmarrjeve në territorin e Kosovës.

5.2 Për qëllimet e këtij neni:

(a) Një ndërmarrje apo degë e saj konsiderohet se vepron në Kosovë nëse kontrolli aktual i menaxhmentit të saj është në Kosovë dhe

(b) Pasuria e një ndërmarrje konsiderohet se ndodhet në territorin e Kosovës nëse pasuria e tillë ndodhet në Kosovë dhe prej datës 10 qershor 1999 është administruar apo

menaxhuar në mënyrë të pavarur nga pasuria e saj jashtë Kosovës, ose nëse përndryshe pasuria e tillë i është nënshtrohet autoritetit të UNMIK-ut.

5.3 Transformimi i mëvonshëm i një ndërmarrje në një formë tjetër të organizatës afariste do të ndikojë në statusin e saj si ndërmarrje në pronësi shoqërore vetëm nëse transformimi i tillë është bërë para datës 22 mars 1989 ose, nëse është bërë më vonë, është:

- (a) Bazuar në ligjin në fuqi dhe
- (b) Është zbatuar në mënyrë jodiskriminuese.

5.4 Regjistrimi i sërishëm apo bashkimi i një ndërmarrje në pronësi shoqërore apo publike pas 22 marsit të vitit 1989 e ndryshon statusin e saj si ndërmarrje shoqërore apo publike vetëm nëse regjistrimi i sërishëm apo bashkimi ka qenë:

- (a) Bazuar në ligjin në fuqi dhe
- (b) Është zbatuar në mënyrë jodiskriminuese.

5.5 Nenet 5.1 dhe 5.2, pavarësisht nga kompetencat administrative të Agjencisë, përveç tjerash, përfshijnë të gjitha ndërmarrjet dhe pasurinë në kuadër të:

- (a) Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/63 të datës 7 dhjetor 2000 mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Tregtisë dhe Industrisë;
- (b) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë;
- (c) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/49, të datës 19 gusht 2000, mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Shërbimeve Komunale;
- (d) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/12 të datës 14 tetor 1999 mbi Sigurimin e Shërbimeve Postare dhe Telekomunikacionit në Kosovë;
- (e) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/23, të datës 21 prill 2000, mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Postës dhe Telekomunikacionit;
- (f) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/25, të datës 21 prill 2000. mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Transportit dhe Infrastrukturës dhe
- (g) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/27 të datës 28 prill 2000, mbi Themelimin e Departamentit Administrativ të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## Neni 6

### Kompetencat administrative të Agjencisë mbi ndërmarrjet

6.1 Agjencia do të ketë kompetenca administrative mbi të gjitha ndërmarrjet. Kompetencat e tilla, përveç atyre të parapara në nenin 6.2, të cilat Agjencia i konsideron të përshtatshme për të ruajtur ose avancuar vlerën, shanset për sukses, ose qeverisjen e ndërmarrjes përkatëse, duke përfshirë:

- (a) Emërimin dhe zëvendësimin e kryetarit, drejtorëve dhe menaxherëve të ndërmarrjes;
- (b) Konstituimin, konfirmimin ose riformimin e bordit mbikëqyrës, bordit menaxhues, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër menaxhues apo mbikëqyrës të ndërmarrjes;
- (c) Zvogëlimin e kompetencave të cilitdo organ të sipërpërmendur;
- (d) Nxjerrjen e udhëzimeve lidhur me veprimtarinë e ndërmarrjes, në veçanti udhëzime për menaxhim të qëndrueshëm financiar;
- (e) Marrjen përsipër të kontrollit të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen, duke përfshirë edhe llogaritë bankare dhe pasurinë, duke i administruar këto llogari dhe pasuri veçmas nga llogaritë e ndërmarrjes;
- (f) Kryerjen e revizionit të jashtëm të ndërmarrjes qoftë në mënyrë direkte ose përmes agjentëve të emëruar;
- (g) Urdhërimin e çdo nëpunësi, kontraktuesi ose ndërmjetësuesi tjetër afarist të ndërmarrjes, që të sigurojë informacionet që i posedon për ndërmarrjen e tillë;
- (h) Urdhërimin e çdo personi që ka kontroll mbi dokumentet e një ndërmarrje t'i mundësojë qasje në dokumentet e tilla për rishikim, kopjim dhe ruajtje;
- (i) Hyrjen dhe inspektimin e lokaleve të ndërmarrjes;
- (j) Aprovimin e planeve të biznesit dhe planeve të investimit të ndërmarrjes;
- (k) Nxjerrjen ose ndryshimin e akteve të themelimit, nënakteve ligjore dhe dokumenteve të tjera përkatëse të ndërmarrjes;
- (l) Regjistrimin e ndërmarrjeve në Kosovë që nuk janë regjistruar në mënyrë adekuate;
- (m) Bërjen e planeve për menaxhimin, rikrijimin ose riorganizimin e ndërmarrjeve;
- (n) Dhënien e koncesioneve ose kontratave të qirasë që lidhen me ndërmarrjet;
- (o) Themelimin e një apo më shumë filialeve të përbashkëta të ndërmarrjeve që janë në pronësi të atyre ndërmarrjeve por që administrohen nga Agjencia dhe transferimin e një pjesë apo tërë pasurisë së ndërmarrjeve në këto filiala;
- (p) Transformimin e ndërmarrjeve në korporata;
- (q) Ristrukturimin e ndërmarrjes në disa ndërmarrje ose korporata;
- (r) Dhënien me nënkontratë të një pjesë të veprimtarisë së ndërmarrjes dhe
- (n) Inicimin e procedurës së falimentimit të ndërmarrjes ose përfaqësimin e ndërmarrjeve të tilla në procedurat e falimentimit.

6.2 Përkritazi me ndërmarrjet në pronësi shoqërore, Agjencia, përveç autorizimeve të parapara në nenin 6.1, ka kompetenca të ndërmarrë masa që ajo i konsideron të përshtatshme për të ruajtur ose avancuar shanset për sukses të veprimtarive përkatëse që kanë të bëjnë me:

(a) Themelimin e një ose më shumë filialeve të përbashkëta të ndërmarrjes në pronësi shoqërore dhe transferimin e një pjese apo tërë pasurisë së ndërmarrjes në filiala të tilla në pajtim me nenin 8;

(b) Shitjen e të gjitha apo një pjesë të aksioneve të filialeve të themeluara sipas paragrafit (a) në pajtim me nenin 8;

(c) Likuidimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në pajtim me nenin 9 dhe

(ç) Vendosjen për posedimin e parave dhe pasurisë tjetër të ndërmarrjes në pronësi shoqërore.

### Neni 7

#### Ushtrimi i kompetencave

7.1 Përveç nëse bordi nuk vendos ndryshe, Agjencia do t'i përmbushë detyrat e parapara sipas këtij kapitulli, duke ushtruar mbikëqyrjen e menaxhimit të përgjithshëm mbi ndërmarrjen, brenda kufizimeve të resurseve të veta administrative.

7.2 Në rastin e nenit 7.1, veprimtaria e përditshme afariste e ndërmarrjeve do të drejtohet nga organet menaxhuese dhe organet e tjera të ndërmarrjes pa i cenuar kompetencat e Agjencisë sipas nenit 6.1.

7.3 Agjencia mund të suppozojë se personat që ushtrojnë detyrën e drejtorit apo menaxherit të ndërmarrjes dhe organet që ushtrojnë kompetencat e kontrollit dhe menaxhimit prej datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje se janë emëruar apo konstituuar në pajtim me ligjin në fuqi, përveç nëse autoriteti kompetent nuk vendos ndryshe.

### Neni 8

#### Themelimi i korporatave ndihmëse të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore

8.1 Në emër të ndërmarrjes në pronësi shoqërore, Agjencia mund të themelojë një apo më shumë korporata dhe t'u transferojë këtyre korporatave të drejtat dhe interesat në tërësi apo pjesërisht të pasurisë së ndërmarrjes përkatëse shoqërore. Agjencia do të vendosë për secilin rast veç e veç se a do t'i marrë përsipër detyrimet e ndërmarrjes shoqërore dhe, nëse i merr, në ç'masë korporata ose korporatat e themeluara në këtë mënyrë do t'i marrin përsipër borxhet e korporatës së caktuar shoqërore, pa paragjykime sa i përketë vazhdimit të përgjegjësisë të së dytës për borxhet ndërmarrja nga korporata e tillë. Aksionet e korporat(ave)ës të themeluara në këtë mënyrë do të jenë në pronësi të ndërmarrjes përkatëse shoqërore dhe do të administrohen nga Agjencia në pajtim me nenin 6.

8.2 Procedurat sipas këtij neni do të udhëhiqen konform Rregullores mbi Organizatat e Biznesit, përveçse kërkesat e themeluesëve nga mbledhja e themelimit të nenit 25 të Rregullores së lartpërmendur nuk do të merren parasysh dhe se deklarata e themeluesit e

nënshkruar nga përfaqësuesi përkatës i autorizuar i Agjencisë do të jetë zëvendësim valid i marrëveshjes së themeluesëve.

8.3 Përderisa në Kosovë të mos bëhet regjistrimi i organizatave të biznesit të autorizuara për dhënie e subjektet juridik, Agjencia, përmes udhëzimit administrativ, mund të bëjë regjistrimin e biznesit për korporatat që ajo i themelon në pajtim me këtë nen. Me regjistrimin e korporatave të tilla sipas procedurave të urdhëresës administrative, ato shpallen si subjekte juridike.

8.4 Agjencia mund të shesë dhe të transferojë një pjesë ose të gjitha aksionet në një korporatë të krijuar në pajtim me këtë nen në emër të ndërmarrjes shoqërore e cila i posedon ato aksione. Afatet e njoftimit dhe periudhat e pritjes të parapara me Rregulloren mbi Organizatat e Biznesit nuk do të merren parasysh sa i përket mbledhjeve të aksionarëve.

8.5 Agjencia ka të drejtë të administrojë shumat e gatshme të parave apo aksionet e fituara nga këmbimi i pasurisë së ndërmarrjes shoqërore që administrohet nga vet Agjencia.

8.6 Të hyrat e fituara nga shitja e aksioneve do të grumbullohen në ndërmarrjen shoqërore e cila i ka poseduar këto aksione, me kusht që shumat e tilla të mbahen në mirëbesim nga Agjencia dhe të shkojnë dobi të kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes përkatëse shoqërore.

8.7 Çfarëdo aksioni i ndërmarrë nga Agjencia sipas këtij neni nuk do cenojë titullarin e pronësisë në ndërmarrjen që është në pronësi shoqërore.

## Neni 9

### Likuidimi vullnetar i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore

9.1 Agjencia mund të iniciojë likuidimin vullnetar të ndërmarrjes në pronësi shoqërore ose të një pjese të saj nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve të ndërmarrjeve të tilla. Agjencia do të administrojë likuidimin në pajtim me procedurat e caktuara me Rregulloren mbi Organizatat e Biznesit, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Rregullore.

9.2 Të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të tilla shoqërore, i kalohen komisionit të likuidimit që do të themelohet në pajtim me nenin 39 të Rregullores mbi Organizatat e Biznesit, përveçse Agjencia do të ketë kompetenca për të emëruara anëtarët e komisionit të tillë të likuidimit.

9.3 Çfarëdo padie gjyqësore kundër një ndërmarrje në pronësi shoqërore që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij neni do të pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia. Kërkesës së tillë duhet bashkëngjitur:

(a) Dëshmi për dorëzimin e njoftimit të përshkruar në nenin 39.3 të Rregullores mbi Organizatat e Biznesit (kur objekt i procedurës së likuidimit është korporata);

(b) Dëshmi për publikimin e informatave të përfshira në atë njoftim në një publikim kryesor në gjuhën shqipe që ka tirazh të gjërë në Kosovë, një herë në javë për dy javë rresht dhe në një publikim kryesor në gjuhën serbe, në pajtim me kriteret që do t'i caktojë bordi;

(c) Dëshmi për paraqitjen e Agjencisë në faqen e internetit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, nëse ekziston faqja e internetit në kohën e likuidimit dhe

(d) Dëshmi për njoftimin e subjekteve për të cilat Agjencia beson, ose është dashur të ketë besuar, se kanë pretendim ndaj ndërmarrjes përkatëse në pronësi shoqërore .

9.4 Me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia, Dhoma e Veçantë mund të anulohet çfarëdo transaksioni të ndërmarrjes shoqërore e cila i është nënshtruar procesit të likuidimit sipas kësaj Rregulloreje, nëse transaksioni është bërë para nëntëdhjetë (90) ditëve, para datës së publikimit të dytë të përshkruar në nenin 9.3 (b).

## Neni 10 Politika operative

10.1 Bordi do të nxjerrë udhëzime të politikës operative për udhëheqjen e gjencisë në ushtrimin e kompetencave të saj sipas këtij kapitulli, me qëllim të:

(a) Sigurimit të pajtueshmërisë me nenin 24.2;

(b) Ruajtjes dhe avancimit të vlerës, shansit për sukses dhe qeverisjes së ndërmarrjeve dhe

(c) Shpërndarjes së resurseve të kufizuara administrative të Agjencisë në veprimtari që gjenerojnë vlerën më të madhe të shtuar.

10.2 Duke pasur parasysh ushtrimin e kompetencave të Agjencisë sipas nenit 6.2, politika operative do të:

(a) Caktojë përcaktojë procedura që do të aplikohen në mënyrë transparente dhe të njëtrajtshme, me qëllim të sigurimit të një konkurrence të drejtë të ofertuesëve dhe fitimin e një vlere të drejtë të tregut për aksionet e korporatës, si dhe pagesën e shpenzimeve të transaksioneve, dhe

(b) Krijojë rrethanat nën të cilat Agjencia mund të kërkojë nga palët që kanë konkurruar për aksione në korporata të prezantojnë plan të realizueshëm biznesi për atë korporatë, duke përfshirë edhe aktivitetet e propozuara, investimet dhe nivelet e punësimit, si dhe dëshmi për mjetet financiare që nevojiten për investimet e parapara në planin e biznesit, dhe të specifikojnë se si këto kritere do të merren parasysh nga Agjencia gjatë vlerësimit të tenderit.

10.3 Linjat e veprimit operativ përfshijnë procedurat për njoftim publik të veprimeve të Agjencisë. Me rastin e transaksioneve sipas:

(a) Neneve 6.1 (l), (ll), (n) dhe 6.2 (a) deri në (c),

(b) Nenit 6.1 (j) kur këto koncesione apo qiraja kanë të bëjnë me një pjesë substanciale të aksioneve më të rëndësishme të ndërmarrjes, ashtu siç është përcaktuar në politikat operacionale dhe

(c) Nenit 6.2 (ç) kur një shitje e tillë përfshin një pjesë substanciale të mjeteve të përgjithshme të ndërmarrjes, siç është përcaktuar në politikën e linjave të veprimit –



procedurat e tilla duhet të sigurojnë se Agjencia do të njoftojë për transaksionin në një gazetë kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjërë në Kosovë dhe një publikim kryesor në gjuhën serbe, së paku dy javë para se transaksioni i tillë të finalizohet dhe të ketë fuqi ligjore.

10.4 Politika operative duhet të ndosë standarde për qeverisje të mirë, të të cilat do t'i imponojë Agjencia ndërmarrjeve, në një masë të realizueshme. Në veçanti, këto standarde duhet:

(a) Të nxisin respektimin e kërkesave të raportimit financiar sipas ligjit në fuqi;

(b) Të sigurojnë revizione vjetore të brendshme të ndërmarrjeve në pajtim me ligjin në fuqi, dhe

(c) Të sigurojë mbrojtje kundër keqpërdorimit të kompetencave menaxhuese, duke përfshirë, prveç tjerash, tregtimin e brendshëm, vjedhjen e pasurisë dhe marrjen e fitimit.

10.5 Përmes politikës operative do të caktohet procedura për regjistrimin e aksioneve nën administrimin e Agjencisë në një regjistër të aksioneve nën autoritetin e Agjencisë, deri në shitjen e këtyre aksioneve në pajtim me nenin 8.4. Këto kompetenca do t'i kalohen qendrës së përgjithshme për regjistrimin e aksioneve pasi të themelohet ajo.

### Kapitulli 3 Organizimi dhe menaxhimi

#### Neni 11 Struktura organizative

11.1 Agjencia do të ketë Bordin e Drejtorëve ("Bordi"), drejtorin menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorë menaxhues ("Menaxhmenti") si dhe stafin profesional e teknik.

11.2 Bordit do t'i jepen të gjitha kompetencat e Agjencisë. Bordi mund t'ia delegojë ushtrimin e kompetencave të veta drejtorit menaxhues dhe t'i ruaj ato kompetenca që janë të rezervuara për Bordin sipas nenit 15.

11.3 Drejtori menaxhues do të jetë kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët e menaxhimit do t'i ushtrojnë ato kompetenca të Agjencisë që u janë kaluar atyre nga Bordi ose me këtë nen.

11.4 Drejtori menaxhues do të drejtojë veprimtarinë e zakonshme të Agjencisë nën kontrollin e përgjithshëm të Bordit, nëse Bordi nuk vendos ndryshe. Ai është përgjegjës, përveç për emërimin dhe shkarkimin e dy Zëvendësdrejtorëve Menaxhues dhe personelit tjetër që mund të caktohet nga Bordi, edhe për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e stafit. Drejtori menaxhues mund të ushtrojë kometenca të tjera që mund t'i delegohen nga Bordi.

#### Neni 12 Përbërja e Bordit

12.1 Bordi dotë ketë tetë drejtorë, katër drejtorë ndërkombëtarë dhe katër drejtorë që janë banorë të Kosovës.

12.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i emërojë drejtorët nga Kosova, njëri prej të cilëve do të jetë zëvendëskryesues. Tre nga drejtorët e Kosovës do të jenë ministra në institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, duke përfshirë edhe ministrin nga komuniteti serb. Drejtori i katërt nga Kosova do të jetë Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

12.3 Drejtorët ndërkombëtarë do të jenë:

(a) Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik i cili, sipas detyrës, do të jetë kryesues i Bordit;

(b) Zëvendësi i zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, i cili në mungesë të kryesuesit të Bordit, do të ushtrojë detyrën e kryesuesit;

(c) Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile dhe

(ç) Drejtori menaxhues i Agjencisë.

12.4 Çdo drejtor mund të caktojë një person që të marrë pjesë në Bord në mungesë të tij. I emëruari i kryesuesit do ta kryejë funksionin pa cenuar nenin 12.3 (b). Emërimet e bëra sipas këtij neni do të hyn në fuqi me rastin e konfirmimit nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

12.4 Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor nëse ai person:

(a) Është dënuar me burgim prej një ose më shumë vite, pas një procedure përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;

(b) Është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të gabimeve të rënda profesionale, pas një procedure përkatëse, në pajtim me standardet ndërkombëtare;

(c) Ka ose përfiton dobi direkte ose indirekte në cilëndo ndërmarrje apo në cilindo person apo subjekt që kërkon të drejtën e pronësisë në ndërmarrje ose

(ç) Ka interesa që përndryshe janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15.

### Neni 13 Mandati i drejtorëve

13.1 Drejtorët, përveç kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Bordit, emërohen për një mandat të përsëritshëm dyvjeçar.

13.2 Drejtorët dhe zëvendësit e tyre nuk marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit, mirëpo, ata mund të paguhen për shpenzime të arsyeshme që i kanë bërë për të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit dhe shpenzimet e arsyeshme që i kanë bërë në përmbushjen e funksioneve të tjera zyrtare në dobi të Agjencisë.

13.3 Drejtorët do t'i kryejnë obligimet e tyre në mënyrë të paanshme duke u shërbyer objektivave të Agjencisë në pajtim me nenin 2. Ata, përveç nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e në përputhje me Kapitullin 5 të kësaj Rregulloreje dhe me ndonjë ligj tjetër në fuqi, nuk duhet të pranojnë udhëzime lidhur me ushtrimin e detyrave të tyre.

13.4 Drejtorët mund t'i shkarkojë nga detyra Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nëse ata:

- (a) Nuk kanë të drejtë të ushtrojnë detyrën e drejtorit sipas nenit 12.5;
- (b) E shfrytëzojnë postin në dobi të ndonjë personi apo subjekti tjetër, përveç Agjencisë;
- (c) Bëhen të paafte të kryejnë detyrat e tyre së paku për një periudhe tremujore;
- (ç) Nuk pajtohen me ndonjë vendim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 5, ose
- (d) I shpërfillin në mënyrë flagrante detyrat e tyre.

13.5 Drejtorët janë të përgjegjës para Agjencisë për pasojat e vendimeve në të cilat ata realisht kanë marrë pjesë nëse:

- (a) Kanë vepruar në kundërshtim me nenin 13.4;
- (b) Kanë ditur ose ka qënë e arsyeshme të dinë se një vendim i tillë është në kundërshtim me këtë Rregullore apo ndonjë ligj tjetër në fuqi ose me ndonjë vendim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose
- (c) Kanë shpërfillur në mënyrë flagrante standardet e administrimit të mirë që duhet të zbatohen për ata që kanë pozita të tilla.

#### Neni 14 Procedurat e Bordit

14.1 Procedurat e Bordit do të caktohen me Statutin e Agjencisë i cili miratohet nga Bordi ("Statuti").

14.2 Mbledhjet e rregullta të Bordit do të konvokohen së paku një herë në muaj. Kryesuesi mund të konvokojë mbledhje plotësuese në çdo kohë, dhe këtë e bën me kërkesën e së paku dy drejtorëve.

14.3 Bordi konsiderohet se ka kuorum nëse janë prezentë së paku pesë drejtorë.

14.4 Vendimet e Bordit do të merren me konsensus. Nëse nuk arrihet konsensus do të votohet.

14.5 Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Rregullore ose me statutin e Agjencisë,.

14.6 Për të siguruar shumicën e kualifikuar me këtë Rregullore ose me statutin e Agjencisë, nevojiten së paku pesë vota pozitive.

14.7 Çdo drejtor ka nga një votë. Në rastet kur kemi vota të barabarta, vota e kryesuesit është vendimtare.

14.8 Statuti mund t'i përcaktojë vendimet që mund të merren vetëm nga kryesuesi. Në raste emergjente, kryesuesi mund të merr vendime të cilat konfirmohen nga Bordi në mbledhjen e ardhshme të Bordit.

### Neni 15 Përgjegjësitë e Bordit

15.1 Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me Rregullore.

15.2 Vendimet e poshtëshënuara të Bordit do të merren me shumicën e kualifikuar dhe mund të mos i delegohen drejtorit menaxhues:

(a) Miratimi i aktit të themelimit, statutit, strukturës së përgjithshme organizative, politikës financiare dhe të revizionit, politikës së plotësimit të vendeve të punës dhe punësimit në Agjenci;

(b) Miratimi i politikës operative sipas nenit 10;

(c) Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit menaxhues, me kusht që drejtori menaxhues të mos merr pjesë në vendimet e tilla dhe vota e tij të ushtrohet nga personi të cilin e cakton kryesuesi në pajtim me nenin 12.4;

(d) Emërimi apo shkarkimi i një zëvendës drejtor të menaxhimit ose ndonjë zyrtari tjetër, emërimi i të cilëve është rezervuar për Bordin;

(e) Konstituimi, konfirmimi ose përbërja e bordit mbikëqyrës, këshillit të punëtorëve ose organit tjetër mbikëqyrës të ndërmarrjes dhe çfaredo përcaktimi apo ndryshimi i kompetencave ose përgjegjësi të organit të tillë;

(f) Vendosja e një ndërmarrje nën administrim direkt të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1 (d);

(f) Miratimi apo ndryshimi i aktit të themelimit, statutit ose dokumenteve të ngjashme të një ndërmarrjeje;

(h) Njohja kur ndërmarrja transformohet në një tip tjetër të organizatës afariste pas datës 22 mars 1989 në pajtim me nenin 5.3;

(i) Nënshkrimi i një marrëveshjeje për menaxhim ose qiradhënie lidhur me ndonjë ndërmarrje në shoqërore në pajtim me nenin 6.1(n);

(j) Dhënia e koncesioneve ose lidhja e kontratave të qirave që kanë të bëjnë me pronën, të drejtat ose veprimtarinë e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në pajtim me nenin 6.1 (n);

- (k) Miratimi i planeve për riorganizimin ose ristrukturimin e ndërmarrjes;
- (l) Miratimi i krijimit të një ose më shumë korporatave nga një ndërmarrje në pronësi shoqërore në pajtim me nenin 8;
- (m) Shitja ose transferi i një pjese ose i të gjitha aksioneve të një korporate të krijuar sipas paragrafit (1) të mësipërm një pale të jashtme;
- (n) Vendimi për likuidimin e një ndërmarrje shoqërore ose pjesë të saj në pajtim me nenin 9;
- (o) Vendimi për fillimin e procedurës së falimentimit në lidhje me një ndërmarrje;
- (p) Miratimi i buxhetit dhe i planeve të punës së Agjencisë për vitin kalendarik vijues;
- (q) Miratimi i punës së menaxhmentit në bazë të raportit vjetor të revizionit dhe
- (r) Vendimi nëse një ndërmarrje e veçantë ose një grup i caktuar i ndërmarrjeve do të konsiderohet nga Agjencia se i plotëson kushtet sipas nenit 5.

## Neni 16 Menaxhmenti dhe personeli

16.1 Drejtori menaxhues, me ndihmën e dy zëvendës drejtorëve menaxhues, është përgjegjës për:

- (a) Kryerjen e të gjitha funksioneve që i janë deleguar atij nga Bordi;
- (b) Zhvillimin e punës së rregullt të Agjencisë në pajtim me politikën dhe udhëzimet që mund të nxirren nga Bordi;
- (c) Organizimin, emërimin dhe largimin nga puna të personelit (përveç zëvendës drejtorëve të menaxhimit dhe zyrtarëve tjerë, emërimin e të cilëve Bordi e ka rezervuar për vete) në pajtim me vendimet e marra ose udhëzimet e nxjerra nga Bordi;
- (d) Përgatitjen e e takimeve të Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit dhe
- (e) Ne marrëveshje me Bordin, kryerjen efarëdo funksioni ndihmës në pajtim me nenin 2.2(b).

16.2 Drejtori menaxhues i raporton Bordit dhe është i përgjegjshëm ndaj tij dhe asnjë pale tjetër.

16.3 Drejtori menaxhues dhe zëvendës drejtorët menaxhues caktohen nga Bordi pas propozimit nga ana e Kryesuesit. Ata, në çdo kohë, mund të largohen nga Bordi. Bordi vendosë

për pagesën dhe kushtet e tjera të shërbimit të drejtorit menaxhues dhe zëvendës drejtorëve menaxhues, pa cenuar nenin e mëposhtëm 16.5.

16.4 Personat e papërshtatshëm për t'u emëruar për drejtor sipas nenit 13.4, nuk kanë të drejtë, poashtu, të emërohen për drejtor menaxhues, përkatësisht zëvendës drejtor menaxhues. Ata, poashtu, nuk janë të përshtatshëm nëse punojnë në ndonjë zyrë publike ose janë anëtarë të ndonjë organi ekzekutiv të një partie politike.

16.5 Agjencisë mund t'i caktohet drejtues dhe personel tjerë nga institucionet e tjera. Në rastet e tilla, pagesa dhe kushtet e tyre personale të shërbimit do të varet nga kontrata e tyre me institucionin që i dërgon. Privilegjet dhe imuniteti i personelit të transferuar, nëse kanë, varen nga privilegjet dhe imunitetet e institucionit që i dërgon dhe marrëdhënia kontraktuese e personelit të transferuar me atë institucion. Kjo rregullë vendos, gjithashtu, për detyrimin e personelit të transferuar sa i përket tatimit në Kosovë.

16.6 Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, menaxhmenti dhe personeli përgjigjen vetëm Agjencisë dhe asnjë pale apo subjekti tjetër. Ata nuk duhet të marrin kurrfarë udhëzimesh sa i përket kryerjes së detyrave të tyre nga asnjë organ tjetër përveç nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me kapitullin 5 të kësaj Rregulloreje, ose nga eprori i tyre hierarkik në Agjenci.

16.7 Menaxhmenti dhe personeli duhet ta ruajnë konfidencialitetin e informatave të fituara gjatë shërbimit të tyre në Agjenci ,qoftë gjatë ose pas shërbimit të tyre për Agjencinë.

16.8 Menaxhmenti dhe personeli nuk bënë të kenë interes të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë në ndërmarrje ose në çfarëdo pale e cila kërkon ndonjë interes në një ndërmarrje të tillë. Menaxhmentit dhe personelit, gjithashtu, i ndalohe marrja e përfitimeve nga çfarëdo pale tjetër përveç nga Agjencia lidhur me çfarëdo veprimi ose mosveprimi të Agjencisë, pa cenuar nenin 16.5.

16.9 Bordi, menaxhmenti dhe personeli nuk i përgjigjen asnjë pale tjetër përveç agjencisë për çfarëdo veprimi ose mosveprimi brenda gushes së autoritetit që iu veshur atyre nga Agjencia. Bordi, menaxhmenti dhe personeli janë përgjegjës ndaj Agjencisë për çfarëdo mosrespektimi të detyrave në pajtim me kontratat e tyre me Agjencinë, pa cenuar nenin 16.5.

## **Kapitulli 4** **Dispozitat financiare**

### Neni 17 Kapitali i Agjencisë

Agjencia do të ketë kapitalin themelues në shumë prej 10 milion eurosh (10.000.000 €), prej të cilave një million euro (1.000.000 €) do të paguhet me të holla të gatshme ose në natyrë brenda gjashtë muaj ditësh pas mbledhjes konstituive të Bordit. Pjesa tjetër do t'i nënshtrohet thirrjes së Bordit, atëherë kur kjo kërkohet për përmbushjen e obligimeve të Agjencisë.

### Neni 18 Përgjegjshmëria, vigjilenca dhe përgjegjësia e Agjencisë

Çdo detyrim i shkaktuar nga Agjencia, qoftë me kontratë ose me anë të veprimit të ligjit, do të kufizohet vetëm në mjetet e Agjencisë plus pjesa e papaguar e kapitalit nominal të saj. Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrëfarë borxhi që lidhet me mjetet e trustit dhe mjetet e trustit nuk mund të prekën për kurrëfarë borxhi të Agjencisë.

18.2 Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrëfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet ndërmarrjeve, ndërsa ndërmarrjet nuk përgjigjen për kurrëfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet Agjencisë.

18.3 Llogaritë dhe mjetet e tjera të ndërmarrjeve që administrohen nga Agjencia do të mbahen në mirëbesim veçmas nga njëra tjetra dhe veçmas nga llogaritë e mjetet e tjera të Agjencisë

18.4 Për çfarëdo veprimi ose mosveprimi sipas nenit 18.1, Agjencia, pa cenuar të drejtën e kërkuesit për kompensim sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 të datës 13 qershor 2002 mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjenciën e Mirëbesimit të Kosovës, do të përgjigjet vetëm nëse një veprim ose mosveprim i tillë:

(a) Është ose jashtë kompetencave që i janë dhënë Agjencisë me anë të kësaj Rregulloreje ose me ndonjë rregullore apo urdhërese tjetër administrative të Përfqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm;

(b) Paraqet keqpërdorim të madh të autorizimeve të Agjencisë sipas kësaj Rregulloreje ose

(c) Paraqet shkelje të obligimeve të kontraktuara që janë shkaktuar nga Agjencia dhe për llogari të saj.

18.5 Çdo detyrim i Agjencisë sipas nenit 18.4 do të kufizohet në personat që pësojnë humbje financiare si rezultat i drejtpërdrejtë i veprimit ose i mosveprimit që ka shkaktuar detyrimin e Agjencisë. Agjencia në asnjë rast nuk është përgjigjet për dëmet që janë si rrjedhim i tërthortë ose pasojë e masave ndëshkuese.

## Neni 19 Politika financiare

Bordi i nxjerrë rregullat e politikës financiare me qëllim që Agjencia ta kryejë aktivitetin e saj në pajtim me praktikën e menaxhimit të shëndoshë dhe të arsyeshëm dhe t'i realizojë zotimet e veta financiare pa kërkuar kapitalin e papaguar në pajtim me nenin 17. Politika e tillë do t'i mundësojë Agjencisë që t'i kërkojë pagesat administrative, pagesat e transaksioneve dhe shërbimeve nga ndërmarrjet, korporatat dhe çdo shfrytëzues tjetër i aktiviteteve të Agjencisë, me kusht që pagesat e tilla të jenë transparente, jodiskriminuese dhe të arsyeshme.

## Neni 20 Raportet, buxheti dhe llogaritë

20.1 Bordi i paraqet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm raporte tremujore, të cilat duhet të përmbledhin aktivitetin e Agjencisë dhe t'i pasqyrojnë rezultatet financiare.

20.2 Bordi publikon një raport vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

- (a) Pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- (b) Veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe të mjeteve tjera që mbahen nga Agjencia në mirëbesim;
- (c) Listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtëpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1;
- (d) Shënimet për transaksionet e kryera në pajtim me nenin 8, të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- (e) Listën e ndërmarrjeve që kanë falimentuar në pajtim me nenin 9 dhe
- (f) Listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e falimentimit.

20.3 Drejtori menaxhues duhet të përgatisë buxhetin vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve të parapara të Agjencisë për miratim nga Bordi.

#### Neni 21 Ndarja e të hyrave neto

Bordi vendos për ndarjen e të hyrave neto të Agjencisë në bazë të rekomandimit të drejtorit menaxhues. Në shkallën e sugjeruar dhe konform praktikave të arsyeshme të menaxhimit, të hyrat e tilla do të ndahen për rezerva. Pjesa e mbetur mund të ndahet në një llogari të veçantë të caktuar nga Bordi, për financimin e aktiviteteve që e shpiejnë përpara objektivin e Agjencisë sipas nenit 2 të kësaj Rregulloreje. Të hyrat e pandara neto do të grumbullohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

#### Neni 22 Kërkimi i kontributeve vullnetare

Agjencia mund të kërkojë kontribute vullnetare për llogarinë e veçantë të refruara në nenin 21. Kontributet e tilla do të shpenzohen për qëllimet për të cilat është arritur pajtimi me kontribusin, me kusht që qëllimet e tilla të jenë në shërbim të realizimit të objektivit të Agjencisë sipas nenit 2 të kësaj Rregulloreje.

#### Neni 23 Trajtimi i taksave

23.1 Të ardhurat dhe prona e Agjencisë përjashtohet nga tatmi, me kusht që përjashtimi i tillë të mos vlejë për ndërmarrjet, korporatat, llogaritë dhe pronën tjetër të administruar nga Agjencia si agjenci besimi.

23.2 Transferi i mjeteve dhe shitja e aksioneve në pajtim me nenin 8 nuk i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar.



## **Kapitulli 5** **Mbikqyrja dhe përgjegjshmëria**

### **Neni 24** **Përgjegjësia e Bordit**

24.1 Bordi ushtron gjykim të pavarur në afarizimin e tij dhe përmbushjen e përgjegjësive të tij sipas kësaj Rregulloreje.

24.1 Përkundër dispozitës së mësipërme, Bordi kolektivisht ndërsa drejtorët individualisht i përgjigjen, në çdo kohë, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sa i përket respektimit:

- (a) Të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nga ana e Agjencisë;
- (b) Të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe çfarëdo rregulloreje tjetër, urdhërese administrative, udhëzimi administrativ ose vendimi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë lidhur me këtë Rregullore;
- (c) Të çdo ligji tjetër të aplikueshëm në Kosovë dhe
- (d) Të aktit themelues, nënakteve, politikës operative e financiare dhe të personelit e të procedurave të punës së Agjencisë, përveç nëse ato janë modifikuar ose shfuqizuar në pajtim me këtë Rregullore.

24.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mundet në çdo kohë:

- (a) Të shfuqizojë ose modifikojë çfarëdo vendimi të Bordit ose të menaxhmentit nëse konsideron se vendimi i tillë nuk është në pajtim me nenin 24.2 dhe
- (b) Të urdhërojë çfarëdo veprimi të Agjencisë, të cilin ai konsideron se është i nevojshëm për respektimin e nenit 24.2.

24.4 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të emërojë drejtorin menaxhues, nëse Bordi dështon në emërimin e drejtorit menaxhues brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbedhjes konstituive ose brenda tridhjetë ditësh (30) pas ditës kur vendi i punës së drejtorit menaxhues është i lirë.

### **Neni 25** **Revizionet e jashtme**

25.1 Do të ketë revizione vjetore të Agjencisë, duke përfshirë edhe revizionet e jashtme financiare, në pajtim me standardet e procedurave operative në fuqi të caktuara nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe revizione plotësuese për të cilat mund të vendos Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

25.2 Revizionet vjetore, përveç në Agjenci, do të shtrihen në çdo ndërmarrje dhe llogari besimi që administrohen drejtëpërsëdrejti nga Agjencia. Fushëveprimi i çfarëdo revizioni plotësues do të përcaktohet, prej rasti në rast, nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

## **Kapitulli 6** **Zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

### Neni 26

#### Ndihma e UNMIK-u ,KFOR-it dhe vetëqeverisja e përkohshme

Agjencia mund të kërkojë ndihmë nga policia dhe agjencitë e tjera të UNMIK-ut, të KFOR-it dhe institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes për zbatimin e autorizimeve sipas kësaj Rregulloreje.

### Neni 27

#### Shqiptimi i gjobave

27.1 Për zbatimin e autorizimeve të veta sipas kësaj Rregulloreje, Agjencia mund të shqiptojë gjoba të referuara në këtë nen ndaj ndërmarrjeve, punonjësve dhe personave të tjerë me funksione menaxhuese ose mbikëqyrëse sa i përket ndërmarrjeve për:

(a) Mosdhënien e përgjigjes brenda pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i Agjencisë për informatat ose dokumentacionin që është në posedim të marrësit – deri në njëqind euro (100 €) në ditë për çdo ditë të mosrespektimit deri në maksimumin prej pesë mijë eurosh (5.000 €);

(b) Dhënien me qëllim të informatave të rrejshme përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë – deri në dhjetë mijë Euro (10.000 €);

(c) Shkatërrimin, falsifikimin, fabrikimin ose fshehjen e së shënimeve që lidhen me ndërmarrjen – deri në dhjetë mijë Euro (10.000 €);

(d) Fshehjen e qëllimshme ose transferimin e paligjshëm të mjeteve të ndërmarrjes – deri në dhjetë mijë euro (10.000 €) ose vlera e pasurisë së fshehur, cilado prej tyre që është më e lartë dhe

(e) Mosdorëzimin Agjencisë të çfarëdo mjeteve të ndërmarrjes pas urdhërit me shkrim nga ana e Bordit – deri në njezetë mijë euro (20,000 E) ose vlera e mjeteve të padorëzuara, cilado prej tyre që është më e lartë.

27.2 Çfarëdo gjobe konform nenit 27.1 duhet të nënshkruhet nga drejtori menaxhues ose zëvendës drejtori menaxhues dhe t'i dorëzohet ndërmarrjes ose personit në fjalë. Ajo hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas dorëzimit, përveç nëse pranuesi brenda kësaj periudhe i bën ankesë me shkrim kryesuesit të Bordit. Në këtë rast ekzekutimi i ndëshkimit do të pezullohet deri sa nuk konfirmohet nga Bordi dhe vërtetimi i tillë t'i dorëzohet ankuesit. Ankuesi mund t'i bëjë ankesë Dhomës së Veçantë. Dhoma e Veçantë mund të pezullojë zbatimin e ndëshkimit, në pritje të vendimit përfundimtar.

Neni 28  
Përgjegjësia për dëmet

Çdo drejtor i ndërmarrjes dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës që ka lidhje me ndërmarrjen është i përgjegjshëm për çfarëdo dëmi të shkaktuar nga ndërmarrja e tillë si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë. Agjencia, në emër të ndërmarrjes në fjalë, ka autorizim të kërkojë pagimin e dëmit të tillë në gjykatën kompetente.

Neni 29  
Të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve

29.1 Asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrjeje nuk do të mbahet në gjykatë nëse kërkuesi nuk sigurohet dëshmi me shkrim se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i kërkuesit, emri i ndërmarrjes ose korporatës dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar.

29.2 Agjencia ka të drejtë ligjore që të kërkojë çfarëdo të drejtash për një ndërmarrjeje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrjeje.

29.3 Kurdo që procedurat ligjore janë në pritje të zgjidhjes së një çështjeje në emër të një ndërmarrjeje ose kundër saj, Agjencia, në çdo kohë, mund ta njoftojë gjykatën kompetente se ajo do të veprojë si përfaqësues ligjor i ndërmarrjes në fjalë, me kusht që ajo të veprojë si përfaqësues ligjor i vetëm një ndërmarrjeje në procedurën ku ka më shumë se një ndërmarrje ose korporatë.

Neni 30  
Paditë gjyqësore kundër agjencionit

30.1 Dhoma e Veçantë ka jurisdikcion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.

30.2 Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala ankuese dorëzon dëshmi se ka njoftuar kryesuesin e Bordit për për të dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit aktual të saj. Dhoma e Veçantë, me kërkesën e Agjencisë, mund të pezullojë hapjen e procedurës të padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë, për të mundësuar një zgjidhje miqësore.

**Kapitulli 7**  
**Dispozitat përfundimtare**

Neni 31  
Përfundimi i kompetencave mbi ndërmarrjet shoqërore

Autorizimet e Agjencisë sipas kësaj Rregulloreje që lidhen me ndërmarrjet shoqërore dhe me llogaritë, aksionet dhe me mjetet e tjera të administruara në emër të ndërmarrjeve të tilla përfundojnë pas kalimit të tri viteve nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi, përveç nëse autorizimet e tilla zgjaten me rregullore.

Neni 32  
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 33  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 13 qershor të vitit 2002.

Michael Steiner ,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm  
(i nënshkruar)

**PËRMBAJTJA**

Kapitulli 1	Statusi ligjor, qëllimi dhe përkufizimet
	Neni 1            Statusi ligjor i Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës
	Neni 2            Objektivi dhe qëllimet
	Neni 3            Përkufizimet
	Neni 4            Referimet
Kapitulli 2	Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë
	Neni 5            Ndërmarrjet nën administrimin e Agjencisë
	Neni 6            Kompetencat administrative të Agjencisë mbi ndërmarrjet
	Neni 7            Ushtrimi i kompetencave
	Neni 8            Themelimi i korporatave ndihmëse të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore
	Neni 9            Likuidimi vullnetar i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore
	Neni 10           Politika operative
Kapitulli 3	Organizimi dhe menaxhimi
	Neni 11           Struktura organizative
	Neni 12           Përbërja e Bordit
	Neni 13           Mandati i drejtorëve
	Neni 14           Procedurat e Bordit
	Neni 15           Përgjegjësitë e Bordit
	Neni 16           Menaxhmenti dhe personeli
Kapitulli 4	Dispozitat financiare
	Neni 17           Kapitali i Agjencisë
	Neni 18           Përgjegjshmëria, vigjilenca dhe përgjegjësia e Agjencisë
	Neni 19           Politika financiare
	Neni 20           Raportet, buxheti dhe llogaritë
	Neni 21           Ndarja e të hyrave neto
	Neni 22           Kërkimi i kontributeve vullnetare
	Neni 23           Trajtimi i taksave
Kapitulli 5	Mbikqyrja dhe përgjegësia
	Neni 24           Përgjegjësia e Bordit
	Neni 25           Revizionet e jashtme
Kapitulli 6	Zbatimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve
	Neni 26           Ndihma e UNMIK-ut, KFOR-it dhe e Institucionet të përkohshme të vetqeverisjes
	Neni 27           Shqiptimi i gjobave
	Neni 28           Përgjegjësia për dëmet
	Neni 29           Të drejtat e Agjencisë në procedurat ligjore kundër ndërmarrjeve
	Neni 30           Paditë gjyqësore kundër Agjencisë

**Kapitulli 7    Dispozitat përfundimtare**

Neni 31	Përfundimi i autoritetit mbi ndërmarrjet në pronësi shoqërore
Neni 32	Ligji në fuqi
Neni 33	Hyrja në fuqi